

VENDIM
Nr. 533, datë 7.8.2012

PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E CIKLIT PARASHKOLLOR NË INSTITUCIONIN
ARSIMOR JOPUBLIK “SHKOLLA FRANCEZE E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të ciklit parashkollor (kopsht), në institucionin arsimor jopublik “Shkolla franceze e Tiranës”, që do të zhvillojë mësimin edhe në gjuhë të huaj.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për ndjekjen e zbatimit të dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha